

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Daily Consulting" sh.p.k.

Sot më datën 23.05.2023

Neni 1 - Forma e Legjislacioni

Shoqëria **"Daily Consulting" sh.p.k.** (më poshtë e quajtur shoqëria) është një shoqëri tregtare private e rregjistruar në Republikën e Shqipërisë në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas Ligjit nr.9901,datë 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Ligjit 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" dhe që e kryen aktivitetin e saj ekonomik sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 2 - Miratimi

Shoqëria fiton të drejtat e personit juridik nga data e regjistrimit në organet kompetente shtetërore.

Neni 3 - Selia

Selia e shoqërisë është në **Tiranë, Rruga "Osman Myderizi" , Pll 6, Ap 12** "Ajo mund të transferohet në çfarëdo vendi tjetër brenda qytetit të Tiranës ose në ndonjë qytet tjetër të Republikës së Shqipërisë me vendim të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë.

Shoqëria mund të hapë filiale, degë apo përfaqësi të saj në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj të cilat do të krijohen në bazë të legjislacionit shqiptar dhe atë të vendeve ku do te ngrihen.

Neni 4 - Kohëzgjatja e veprimtarisë

Kohëzgjatja e shoqërisë është për një periudhë të pakufizuar dhe mund te zgjidhet para kohe me vendim të Asamblesë së Ortakëve.



Neni 5 - Objekti

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj: “ Shoqëri për ndërmjetësim tregtar dhe konsulencë financiare, risku, ligjore, tregtare, plane biznesi dhe marketingu, konsulencë kreditimesh, etj. Përfaqësimi në Gjykatë dhe mbrojtja e interesave të klientëve të shoqërisë për çështje të ndryshme. Shërbimin Call Center. Ofrimin dhe kryerjen e konsulencës ligjore të fokusuar në çështjet tregtare, civile, fiskale, etj. Gjenerimi i punëve të tjerëve (sipas parashikimit të nenit 648-652 të Kodit Civil.). Shoqëria mund të kryej çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të bëjë çdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj” .

Neni 6 - Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është **100.000 Leke (njëqint mijë leke)**

Neni 7 – Ortakët e Shoqërisë dhe kuotat e zotëruara prej ortakëve

Ortakët e shoqërisë dhe kuotat e zotëruara prej tyre në Shoqëri janë si më poshtë:

Znj. ERTA SADUSH MEHMETI , e lindur në Çorovodë, më dt.24.08.1989, banuese në Rr.“Fecorr Lalari” Banesa nr.2, Fier, Shqipëri, shtetase shqiptare mbajtëse e kartës së identitetit me nr. 032761085, zotërues i një Kuote në masën 100% ose 100,000 Leke.

Neni 8 - Kushte ekonomike

Ortakët e shoqërisë " **Daily Consulting** " sh.p.k përballojnë humbjet e saj vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit në kapitalin themelor.

Shoqëria është pronare e pasurive të saj dhe ka të drejtën e përdorimit dhe disponimit të kësaj pasurie në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë që kryen.

E ardhura bruto e shoqërisë, pasi zbriten amortizimi i të gjithë pasurive të luajtëshme e të paluajtëshme, sipas niveleve të miratuara, pagat, shtesat mbi pagë dhe shpenzime të tjera që lidhen me to, shpenzimet për lëndët e para apo ndihmëse, energjinë si dhe shpenzime të përgjithëshme të reparteve të shoqërisë, ato prodhuese e jo prodhuese, humbjet e vitit të mëparshëm, çdo shpenzim i lejuar dhe taksa mbi fitimin, merret nga ortaku i vetëm i shoqërisë.

Shoqëria gjithashtu nga fitimi i realizuar gjatë vitit financiar lë menjandë një shumë

me vlerë të paktën 1/20 e tij e cila destinohet për formimin e fondit rezervë derisa ky fond të arrije 1/10 e kapitalit themelor.

Veprimtaria do të zhvillohet në bazë të parimeve ekonomike dhe do të pasqyrohet periodikisht në bilancet dhe llogaritë vjetore përkatëse sipas legjislacionit të kontabilitetit në fuqi.

Neni 9 - Trashëgimia e transferimi

Kapitali themeltar është lirisht i trashëgueshëm në rrugë trashëgimie. Ai është lirisht i transferueshëm në rast të ndarjes së pasurisë midis bashkëshortëve, paraardhësve e pasardhësve. Ai gjithashtu është lirisht i transferueshëm tek persona të tretë me vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 10- Bilanci i Shoqërisë. Kontabiliteti

Bilanci i Shoqërisë shqyrtohet nga Ortakët e Shoqërisë dhe do të përgatiten për dorëzim tek organet tatimore përpara fundit të muajit Mars të vitit pasardhës. Librat kontabël do të mbahen në gjuhën shqipe dhe në monedhën vendase (Leke). Shoqëria mund të mbajë llogari të tjera në monedhë të huaj, shuma këto të cilat do të konvertohen në monedhën vendase çdo muaj.

Neni 11 - Kontrata e punës

Marrëdhëniet e punës në shoqëri, filial apo degë rregullohen në bazë të kontratës së punës që lidhet midis punonjësit dhe drejtuesve të shoqërisë. Për çështjet që nuk rregullohen në të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar të punës.

Neni 12 - Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Administratori i saj. Asambleja e Ortakëve është organi vendimor i shoqërisë i cili ka gjithë kompetencat dhe fuqitë për të marrë vendimet përkatëse në lidhje me ndryshimet në statut, shtimin apo pakësimin e kapitalit themelor, emërimin e administratorëve, të ekspertëve kontabël, zgjatjen ose pushimin e veprimtarisë si dhe hapjen ose mbylljen e filialëve.

Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Ortakëve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen apo të fshihen. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti

ka pasur apo duhej të kishte pasur dijeni për pavlefshmërinë.

Organi administrativ i shoqërisë është Administratori, i cili zgjidhet nga Asambleja e Ortakëve, për një periudhë pesë vjeçare. Administratorit i jepen të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë pa kufizim, për arritjen dhe kryerjen e objektit shoqëror me përjashtim të kompetencave të sipërpërmendura që statuti ja rezervon Asamblesë së Ortakëve. Pra Administratorit i takon përfaqësimi i shoqërisë para të tretëve, në gjykatë e arbitrazhe, para administratës shtetërore e organeve financiare.

Administratori i shoqërisë është Znj. ERTA SADUSH MEHMETI , e lindur në Çorovodë, më dt.24.08.1989, banuese në Rr.“Fecorr Lalari” Banesa nr.2, Fier, Shqipëri, shtetase shqiptare mbajtëse e kartës së identitetit me nr. 032761085.

Neni 13 - Likujdimi

Aktiviteti i shoqërisë mund të pushojë në rastin e parashikuar në nenin 4 të këtij statuti ose në raste të tjera të parashikuara në ligj.

Shoqëria mund të mbyllet në formën e riorganizimit ose të likujdimit. Në rastin e likujdimit, Asambleja e Ortakëve emëron një likujdator i cili vepron në bazë të dispozitave përkatëse në fuqi.

Neni 14 - Referimi në ligj

Përsa nuk është parashikuar në statut i referohet ligjit përkatës në fuqi.

Ky dokument redaktohet në 4 (katër) kopje origjinale

ORTAKET E SHOQERISE

ERTA SADUSH MEHMETI

Erta Mehmeti
[Signature]